



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 306/14Prot

Tiranë, më 30/06/2016

V E N D I M

Nr. 82, Datë 30/06/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË DREJTORINË RAJONALE TË TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ TIRANË,
“MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR NË PROCESIN E REALIZIMIT
TË TË ARDHURAVE TATIMORE, KONTRIBUTET E SIGURIMEVE
SHOQËRORE E SHËNDETËSORE SI DHE VLERËSIMI E FUNKSIONIMI I
KONTROLLIT TATIMOR”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar në ballafaqimin e organizuar me dakordësinë e tij më datë 24.06.2016 dhe observacionet e dërguara në KLSH nga data 22.06.2016 deri më datë 28.06.2016, mendimin për cilësinë e auditimit të dhënë nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhënë nga Kryeaudituesi i Departamentit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit dhe Sekretari i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe vlerësimi e funksionimi i kontrollit tatimor” për periudhën nga 01.01.2014 – 31.12.2015

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional u konstatuan se në dosjet e kontrollit mungonte një analizë e detajuar e shpenzimeve të paraqitura në PASH, ku si objekti i kontrollit është tatim fitimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me manualin e kontrollit të miratuar me nr. 5045, datë 22.02.2011.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 50-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Në çdo raport kontrolli të bëhet një analizë më e hollësishme e shpenzimeve të subjektit duke i ndarë shpenzimet me faturë dhe shpenzimet e pa deklaruar në FDP (shpenzime pa faturë tatimore por të justifikuar me dokumentacion të rregullt të njohur fiskalisht), që të jetë e mundur rakordimi midis blerjeve të deklaruar në FDP dhe shpenzimeve në PASH.

Afati: Në vazhdimësi

2. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional u konstatuan se në raportet e kontrollit të subjekteve në analizën e importeve mungojnë të dhëna për referencat doganore për të mundësuar një analizë të shpenzimeve të deklaruar në FDP me shpenzimet në bilanc.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 50-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Të pasqyrohet dhe të analizohet, në raportin e kontrollit të subjektit analiza e detajuar e TVSH-së së importeve duke pasqyruar veçmas TVSH-në për faturën e origjinës dhe referencën në doganë, për të mundësuar një kontroll sa më real të situatës financiare të subjekteve objekt kontrolli.

Afati: Në vazhdimësi

3. Nga auditimi i Drejtorisë së Borxhit, nisur nga numri i madh i subjekteve debitore si dhe vlera e borxhit tatimor, gjatë periudhës objekt auditimi, janë marrë masa jo të mjaftueshme shtrënguese në rikuperimin e borxhit tatimor. Nga auditimi rezultoi se në totalin e masave shtrënguese peshën kryesore si në numër subjektësh dhe në vlerë, e zë masa “Njoftim për pagesë” dërguar tatimpaguesve, duke vazhduar pastaj me masën e dytë që është “Urdhër Bllokim i Llogarive Bankare” ku dhe fillojnë të vështirësohen masat ndaj tatimpaguesve. Në vijim rezultoi se nuk është marrë masa “Urdhër Sekuestrim i Pasurisë” pasi nga verifikimi i pasurive të tatimpaguesve ka rezultuar se janë pasuri të cilat janë në kolateral të bankave pasi kanë kredi.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 107-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të merren masa të plota lidhur me mënyrën e programimit të ardhurave tatimore duke përfshirë në këtë zë edhe të ardhurat që sigurohen nga programi i rikuperimit të borxhit tatimor.

Afati: Në vazhdimësi

4. Nga auditimi i Drejtorisë së Borxhit, rezultoi se është konstatuar se fotografimi i borxhit në nivel DPT-je, në vitin 2014 rezultoi një shtim borxhi në vlerën prej rreth 7,914 milion lekë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 107-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Nga Drejtoria Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, të evidentohet dhe saktësohet vlera e borxhit si dhe koha e lindjes së tij, duke korrigjuar vlerën e borxhit në çelje dhe gjatë vitit 2014. Të merren masa të menjëhershme për rakordimin e gjendjes së borxhit tatimor nga ana e Sektorit të Mbledhjes së Borxhit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me gjendjen e tij.

Afati: Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet eprore dhe paralele, i rekomandojmë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesve të Mëdhenj, ***marrjen në shqyrtim, evidentimin dhe kontabilizimin e tyre, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, në lidhje me detyrimet tatimore të pa përlogaritura dhe të pa kontabilizuara***, të cilat në total janë në shumën **713,122,212 lekë**, për praktikatat e mëposhtme:

1. Për 13 raste (*subjekte*) në shumën **552,408,541 lekë**, për detyrimet dhe penalitetet të evidentuara nga shqyrtimi i raporteve të kontrollit tatimor për periudhat e vitit 2014-2015, për të cilën rekomandojmë lëshimin e njoftim vlerësimit përkatës për vjeljen e detyrimeve të lindura, ku është vepruar në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar.

Afati: Deri 31.12.2016

2. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për të vlerësuar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, rezultuan se nuk ka penalizuar subjektet, që kanë sjellë me vonesë vendimin e organit përgjegjës dhe paguar me vonesë tatimin mbi dividendin, në shkelje të nenit 33/1, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe Neni 117 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” për 27 raste, në vlerën **128,692,173 lekë**.

Afati: Deri 31.12.2016

3. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për të vlerësuar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, rezultuan se nuk ka penalizuar subjektet, për mos likuidim të tatimit mbi të ardhurat në burim, për çdo muaj në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës së kështit të qirasë, në shkelje të nenit 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar për 16 raste, në vlerën **17,716,498 lekë**.

Afati: Deri 31.12.2016

4. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për të vlerësuar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, rezultuan se nuk është vepruar për të kryer tatimin mbi dividendin në masën 15% të fitimit të shpërndarë për çdo subjekt, në shkelje të neni 9, pika 2; nenit 33/1, pika 1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, për 3 subjekte, në vlerën **10,975,000 lekë**.

Afati: Deri 31.12.2016

5. Për 60 subjekte të mosvendosjes së penaliteteve në vlerën **3,000,000 lekë**, sipas aneksit nr. 3.2.1 dhe 3.2.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 126 “Mosdhënia e informacionit”.

Afati: Deri 31.12.2016

6. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për të vlerësuar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, rezultuan se nuk janë penalizuar subjektet që nuk kanë dorëzuar brenda afateve ligjore, vendimet e ortakut apo të ortakëve në shkelje të nenit 33/1 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar për 3 raste, në vlerën **330,000 lekë**.

Afati: Deri 31.12.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (ç) “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

1. Z. N. Xh, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerje e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

-Për mos penalizim të subjekteve, që nuk kanë dorëzuar brenda afateve ligjore, vendimet e ortakut apo të ortakëve.

-Për mos penalizim të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari ekonomike në objekte apo terrene të kontraktuar me qira, për mos likuidim të tatimit mbi të ardhurat në burim, për çdo muaj në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës së këstit të qirasë.

-Për mos penalizim të subjekteve, që kanë vendosur të bëhet ndarja e fitimit dhe vendimi është marrë mbas datës 31 korrik të vitit 2014, jashtë afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, nuk është vepruar për të penalizuar për çdo subjekt që e ka sjellë me vonesë vendimin e organit përgjegjës të subjektit.

-Për mos penalizim të subjekteve që kanë vendosur të bëhet ndarja e fitimit të vitit ushtrimor 2014 për gjatë vitit, pa u mbyllur viti financiar, nuk është vepruar për të kryer ndalesën e tatimit mbi dividentin në masën 15% të fitimit të shpërndarë për çdo subjekt.

Në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 33/1, 2, 3, dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 117.

Neni 58, germa (c) “pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

2. Znj. A. K, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

3. Znj. B. Ç, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

4. Znj. D. M, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

5. Znj. K. N, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

6. **Znj. L. P**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
7. **Z. N. T**, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
8. **Z. D. P**, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
9. **Znj. V. D**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
10. **Znj. M. B**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
11. **Znj. I. D** Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
12. **Znj. L. C** Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerje e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

13. **Z. A. H**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
14. **Z. P. LI**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
15. **Z. R. A**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
16. **Z. Z. D**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
17. **Z. B. M**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
18. **Z. D. M**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit.

Shënim:

Për punonjësit: znj. P. M, znj. A. M, znj. A. N, znj. N. P, znj. E. K, znj. A. B, z. D. T, z. B. F, z. A. S, z. M. M, z. P. K, z. P. K dhe z. I. K *të cilët janë atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për mangësi në zbatimin e detyrave funksionale, por në raste të veçanta, nuk rekomandohen masa disiplinore.*

Ndërsa, për punonjësit znj. R. K, z. R. J, z. M H

Shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë në nivelin e masës disiplinore neni 58, germa (c), “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por që nuk janë rekomanduar, për arsye se kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

D. TË TJERA

Nisur nga fakti që ballafaqimi i datës 24.06.2016 u zhvillua përpara mbërritjes së observacioneve përfundimtare nga ana e subjektit të auditimit, grupit të auditimit, përgjegjësit të grupit të auditimit dhe Kryeaudituesit të Departamentit të Auditimit i jepet vërejtje për mosrespektimin korrekt të standardeve të auditimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë lidhur me gjetjet, konstatimet dhe rekomandimet e Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R